



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 313/1 Prot.

Tiranë, më 14/042015

VENDIM

“Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 27, datë 14/04/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesja/Znj. _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr. 313 Prot., datë 10.04.2015, ndaj Autoritetit Publik/ **Zyra vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Kuçovë**, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit”. Ankuesja/Znj. _____ ka paraqitur pranë autoritetit publik/ Zyra vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), kërkesën datë 26.03.2015, me objekt “Kërkesë për informacion”. Ankuesja ka kërkuar të informohet lidhur me identitetin e pronarit të tokës, për të cilën pretendon se ajo vetë është pronare.

Komisioneri, pas vlerësimit të ankesës, verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore, kontaktoi me Kryeministrinë, autoriteti ku znj. _____ ka depozituar kërkesën fillimisht. Kryeministria me anë të shkresës nr. 810/4, datë 9.04.2015 ka informuar Znj. _____ se shkresa e saj i është dërguar për ndjekje Zyrës Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kuçovë, e cila i ka thyer përgjigje me anë të shkresës nr. 129/1, datë 26.02.2015 duke vënë në dijeni dhe Znj. _____

Me anë të kësaj shkresë ZVRPP Kuçovë ka argumentuar se, ankuesja nuk është pronare e truallit por e ndërtesës mbi këtë truall, për këtë arsye nuk mund të kërkojë këtë informacion. Gjithashtu lidhur me pretendimin e ankueses për mos marrje të përgjigjes, u konstatua se ky pretendim nuk qëndron ndërsa çështja e identifikimit të pronësisë mbi këtë truall nuk është objekt i ligjit për të drejtën e informimit.

Në lidhje me ankesën e Znj. _____ ndaj Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Kuçovë, Komisioneri vlerëson se, ajo rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin tërësisht të ankesës nr.313 Prot., datë 10.04.2015 të Znj. kundër autoritetit publik/ Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Kuçovë.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 14.04.2015.


Besnik DERVISHI
KOMISIONERI

KOMISIONI I DREJTËS SË INFORMIMIT
DHE Mbrojtjes së Detyruesve të të Detyruesve të
TIRANË